



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:239606
Datë: 27.02.2024
Numri i dokumentit: 05380676

C.nr.921/2013

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N. B., me seli në Prishtinë, kundër të paditurve A. K. dhe H. K., me objekt kontesti kthimin e kredisë, jashtë seance me datë 27.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar padia e paditësit N. B., me seli në Prishtinë, në këtë çështjen juridike kontestimore, kundër të paditurve A. K. dhe H. K.

A r s y e t i m

Paditësi ka paraqitur padi në këtë gjykatë më 12.04.2013, kundër të paditurit, me objekt kontesti kthimin e kredisë.

Gjykata me aktvendimin e datës 02.02.2024, e ka detyruar paditësin për deponimin e mjeteve në emër të paradhënies për shpenzimet e përfaqësuesit të përkohshëm, po ashtu është njoftuar se gjykata do ta hedh poshtë padinë nëse brenda afatit kohor prej 7 ditësh, nuk i dorëzon gjykatës dëshmi se është bërë deponimi i mjeteve të cekura si në aktvendim.

Paditësi deri në datën e dhënies së këtij aktvendimi nuk i pa prezantuar gjykatës dëshmi se ka vepruar sipas aktvendimit të cekur si më lartë.

Gjykata në rastin konkret nuk ka mundësi të veprojë tutje sipas padisë së paditësit, kjo për shkak se paditësi brenda afatit të caktuar nga gjykata nuk ka vepruar konform aktvendimit, pra nuk ka bërë deponimin e mjeteve në emër të paradhënies për shpenzimet e përfaqësuesit të përkohshëm, andaj gjykata nuk pati mundësi që të paditurës t'ia cakton përfaqësuesin e përkohshëm dhe si rezultat i kësaj kjo procedurë nuk pati mundësi të zhvillohet dhe u vendos si të dispozitiv të këtij aktvendimi.

Andaj meqenëse paditësi nuk ka vepruar konform nenit 391 pika g), të LPK-së, nuk ka ndërmarrë veprime për eliminimin e mangësive të konstatuara dhe nuk i ka hequr mungesat nga neni 79 dhe neni 102 par. 3 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.921/2013, më 27.02.2024.

Përparim Zeka

Gjyqtar

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 15 ditësh, nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë